

**KOMBET E
BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen
Penale të Personave Përgjegjës për
Shkelje të Rënda të së Drejtës
Humanitare Ndërkombëtare të Kryera
në Territorin e ish-Jugosllavisë prej
Vitit 1991

Lënda Nr. IT-04-84bis-T

Data: 2 dhjetor 2011

Originali: anglisht

NË DHOMËN GJYQËSORE II

Para: Gjykatësit Bakone Justice Moloto, Kryegjykatës
Gjykatësit Burton Hall
Gjykatësit Guy Delvoie

Sekretari: Z. John Hocking

Urdhër: 2 dhjetor 2011

PROKURORI

k.

**RAMUSH HARADINAJT
IDRIZ BALAJT
LAHI BRAHIMAJT**

PUBLIK

**URDHËR PËR REDAKTIMIN E DISA PJESËVE NË VENDIMIN MBI MOCIONIN
E HARADINAJT PËR NXJERRJEN E MATERIALEVE SHFAJËSUESE LIDHUR
ME DËSHMITARIN 81**

Zyrës së Prokurorit:

Z. Paul Rogers

Avokatëve të të Akuzuarve:

Z. Ben Emmerson QC dhe Z. Rodney Dixon për Ramush Haradinajn
Z. Gregor Guy-Smith dhe Zj. Colleen M. Rohan për Idriz Balajn
Z. Richard Harvey dhe Z. Paul Troop për Lahi Brahimajn

KJO DHOMË GJYQËSORE (“Dhoma”) e Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991;

DUKE MARRË SHËNIM “Vendim mbi Mocionin e Haradinajt për Nxjerrjen e Materialeve shfajësuese lidhur me Dëshmitarin 81”, lëshuar konfidencialisht më 18 nëntor 2011” (“Vendim”), nëpërmjet të cilit Dhoma i urdhëroi palët që të paraqisnin parashtrime ku të bënin të ditur cilat pjesë të Vendimit duhen redaktuar, në qoftë se ka të tilla, për hir të ruajtjes së konfidencialitetit para se Vendimi të bëhet publik;

DUKE MARRË SHËNIM “Parashtrim i Prokurorisë Në Zbatim të Urdhrit të Dhomës Gjyqësore të 18 nëntorit 2011”, dorëzuar konfidencialisht më 18 nëntor 2011, nëpërmjet të cilit Prokuroria kërkon të redaktohen disa pjesë të paragrafëve 13, 14 dhe 19 të Vendimit;

DUKE MARRË SHËNIM “Parashtrim i Mbrojtjes në emër të Ramush Haradinajt mbi Redaktimet në Urdhrin e Dhomës Gjyqësore të 18 nëntorit 2011”, dorëzuar konfidencialisht më 25 nëntor 2011 nëpërmjet të cilit Haradinaj kërkon që Vendimit të mos i bëhet asnjë redaktim;

DUKE MARRË SHËNIM “Parashtrim i Idriz Balajt dhe Bashkim me Parashtrimin e Ramush Haradinajt mbi Redaktimet në Urdhrin e Dhomës Gjyqësore të 18 nëntorit 2011”, dorëzuar konfidencialisht më 25 nëntor 2011 dhe “Parashtrim i Lahi Brahimaajt dhe Bashkim me Parashtrimin e Mbrojtjes në emër të Ramush Haradinajt mbi Redaktimet në Urdhrin e Dhomës Gjyqësore të 18 nëntorit 2011”, dorëzuar konfidencialisht më 25 nëntor 2011, nëpërmjet të cilëve Balaj dhe Brahimaajt i bashkohen tërësisht qëndrimit të Haradinajt;

DUKE MARRË PARASYSH nevojën e ruajtjes së konfidencialitetit të identitetit të Dëshmitarit 81 dhe vendbanimit të tij aktual;

PËR ARSYET E LATRPËRMENDURA dhe BAZUAR në Rregullat 54, 69 dhe 75 të Rregullores së Procedurës dhe Provave;

MIRATON kërkesën e Prokurorisë për redaktime **TË PJESSHME** që parashtrohen në Shtojcën Publike A;

URDHËRON që Sekretaria të riprotokollojë versionin publik të Vendimit që bashkëngjitet si Shtojca Publike A.

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

/nënshkruar në origjinal/
Gjykatës Bakone Justice Moloto
Kryegjykatës

Sot, më 2 dhjetor 2011.
Në Hagë
Holandë

[Vula e Tribunalit Ndërkombëtar]

PROKURORI

k.

**RAMUSH HARADINAJT
IDRIZ BALAJT
LAHI BRAHIMAJT**

SHTOJCA PUBLIKE A

**KOMBET E
BASHKUARA**

Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen
Penale të Personave Përgjegjës për
Shkelje të Rënda të së Drejtës
Humanitare Ndërkombëtare të Kryera
në Territorin e ish-Jugosllavisë prej
Vitit 1991

Lënda Nr. IT-04-84bis-T

Data: 18 nëntor 2011

Origjinali: anglisht

NË DHOMËN GJYQËSORE II

Para: Gjykatësit Bakone Justice Moloto, Kryegjykatës
Gjykatësit Burton Hall
Gjykatësit Guy Delvoie

Sekretari: Z. John Hocking

Vendim: 18 nëntor 2011

PROKURORI

k.

**RAMUSH HARADINAJT
IDRIZ BALAJT
LAHI BRAHIMAJT**

VERSIONI I REDAKTUAR PUBLIK

**VENDIM MBI MOCIONIN E HARADINAJT PËR NXJERRJEN E
MATERIALEVE SHFAJËSUESE LIDHUR ME DËSHMITARIN 81**

Zyrës së Prokurorit:

Z. Paul Rogers

Avokatëve të të Akuzuarve:

Z. Ben Emmerson QC dhe Z. Rodney Dixon për Ramush Haradinajn
Z. Gregor Guy-Smith dhe Zj. Colleen Rohan për Idriz Balajn
Z. Richard Harvey dhe Z. Paul Troop për Lahi Brahimajn

KJO DHOMË GJYQËSORE (“Dhoma”) e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991 (“Tribunali”) ka marrë “Mocion i Mbrojtjes në Emër të Ramush Haradinajt për Nxjerrje Urgjente të Materialeve Shfajësuese Lidhur me Dëshmitarin 81, me Shtojca Konfidenciale A dhe B” (“Mocion”), dorëzuar konfidencialisht më 4 tetor 2011.

I. HISTORIA PROCEDURALE DHE PARASHTRIMET

1. Nëpërmjet këtij Mocioni kërkohet që Dhoma të urdhërojë Prokurorinë që të nxjerrë një numër kategorish të dokumenteve të përcaktuara, për të cilat Haradinaj deklaron se mund të ndikojnë besueshmërinë e Dëshmitarit 81 dhe/ose të cilat janë juridikisht të rëndësishme në përgatitjen e Mbrojtjes.¹ Balaj dhe Brahimaj i bashkohen tërësisht Mocionit.² Më 19 tetor 2011, Prokuroria dorëzoi një përgjigje ndaj Mocionit³ së cilës Mbrojtja iu kundërpërgjigj më 26 tetor 2011.⁴

2. Haradinaj parashtron se ai ka marrë nga Prokuroria dy deklarata të redaktuara të Dëshmitarit 81, përkatësisht më 3 dhe 15 dhjetor 2010. Deklarata e parë u nënshkrua më 26 nëntor 2010 dhe u bazua në intervistat e kryera më 23 – 26 nëntor 2010 (“Deklarata e Parë”);⁵ dhe e dyta duket se është nënshkruar më 8 dhjetor 2010 pas intervistave të kryera më 7 dhe 8 dhjetor 2010 (“Deklarata e Dytë”).⁶

¹ Mocion, para 1, 5; Mbrojtja kërkon tejkalimin e numrit-kufi të fjalëve në Mocionin e saj. Shih Mocion, sh 1.

² Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Kërkesë e Idriz Balajt për Bashkim me Mocionin, dorëzuar konfidencialisht më 11 tetor 2011; Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Kërkesë e Lahi Brahimajt për Bashkim me Mocionin, dorëzuar konfidencialisht më 12 tetor 2011;

³ Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Mocionit të Haradinajt të 4 tetorit 2011 Me Shtojca Konfidenciale A-B (“Përgjigje”), dorëzuar konfidencialisht më 19 tetor 2011.

⁴ Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Kërkesë për Leje për Kundërpërgjigje dhe Kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes së Prokurorisë për Mocionin e Mbrojtjes në Emër të Ramush Haradinajt për Nxjerrjen Urgjente të Materialit Shfajësues Lidhur me Dëshmitarin 81 (“Kundërpërgjigje”) dorëzuar konfidencialisht më 26 tetor 2011. Gjithashtu Mbrojtja kërkon tejkalimin e numrit-kufi të fjalëve për këtë parashtrim. Shih Kundërpërgjigje, sh 1

⁵ Shtojcë Konfidenciale A e Mocionit.

⁶ Shtojcë Konfidenciale B e Mocionit. Në deklaratë lexohet se ajo u nënshkrua më 8 nëntor 2010, mirëpo duhet të jetë gabim duke marrë parasysh se deklarata bën të ditur se intervistat u bënë më 7-8 dhjetor 2010 dhe se në paragrafin 20 Dëshmitari 81 shprehet “Gjatë intervistës sime të mëhershme më 25/11/2010 përmenda se [...]”. Dhoma gjykon se ka të ngjarë që deklarata të jetë nënshkruar më 8 dhjetor 2010 pas përfundimit të intervistës, dhe jo më 8 nëntor 2010.

3. Parashtrohet se në Deklaratën e Dytë ka një numër referencash për korrigjimet e bëra nga Dëshmitari 81 gjatë intervistave që rezultuan në Deklaratën e Parë,⁷ mirëpo se këto ndryshime nuk përmenden në Deklaratën e Parë.⁸ Haradinaj deklaroi se ndryshimet kanë të bëjnë me “aspekte absolutisht thelbësore të dëshmisë së tij” si identiteti i autorëve të pretenduar të krimeve të Pikës 1, identiteti i viktimave të pretenduara, nëse viktimat u larguan të gjallë nga Jabllanica dhe nëse Dëshmitari 81 ka parë një viktimë tjetër të pretenduar në Jabllanicë, të përmendur në Aktakuzë.⁹

4. Më herët Haradinaj i kërkoi Prokurorisë më 18 janar 2011 që të nxirrte të gjitha deklaratat e bëra nga Dëshmitari 81, të gjitha materialet që tregojnë se si Zyra e Prokurorit (“Prokuroria”) fillimisht mësoi për dëshmitarin, të gjitha kontaktet e Prokurorisë me Prokurorin, dhe informacion mbi pjesëmarrjen e tij në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve.¹⁰

5. Sipas Haradinajt, Prokuroria refuzoi nxjerrjen e këtyre materialeve duke deklaruar se i kishte përmbushur detyrimet e Rregullës 68, se ndryshimet në Deklaratën e Parë ishin bërë elektronikisht, dhe se nuk ekzistonte dokument i ndryshimeve të bëra nga dëshmitari para nënshkrimit të Deklaratës së Parë prej tij.¹¹

6. Më 28 janar 2011, Haradinaj dorëzoi një mocion ku kërkonte që Dhoma të urdhëronte Prokurorinë që të nxirrte materialin në fjalë, duke argumentuar veçanërisht se deklaratës së dëshmitarit i ishin bërë ndryshime themelore gjatë intervistave të 23-26 nëntorit 2010; dhe se këto ndryshime mund të çenojnë besueshmërinë e dëshmitarit.¹²

⁷ Mocion, para 7.

⁸ Mocion, para 8.

⁹ Mocion, para 8.

¹⁰ Mocion, para 9.

¹¹ Mocion, para 10.

¹² Mocion, para 13. Shih edhe *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Mocion në Emër të Ramush Haradinajt për Nxjerrje të Materialeve Lidhur me Dëshmitarin 81, dorëzuar konfidencialisht më 28 janar 2011, para 2, 5, 6. Shih gjithashtu *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Kundërpërgjigje në Emër të Ramush Haradinajt ndaj Përgjigje së Prokurorisë për Mocionin për Nxjerrje të Materialeve Lidhur me Dëshmitarin 81, Me Shtojca Konfidenciale A dhe B, dorëzuar konfidencialisht më 18 shkurt 2011. Haradinaj kërkoi konkretisht nxjerrjen e këtij materiali; ((i) një listë të ndryshimeve të bëra në deklaratë para se të nënshkruhej nga Dëshmitari 81; (ii) të gjitha dokumentet nga takimet dhe intervistat me dëshmitarin; (iii) të gjitha materialit dhe dokumentet që dëshmitari i ka dhënë Prokurorisë; (iv) një shpjegim sesi mësoi Prokuroria fillimisht për dëshmitarin dhe dokumentin përkatës; dhe (v) informacion mbi çfarëdo mase ose programi mbrojtës për dëshmitarin.

7. Haradinaj parashtroi se përgjigjja e Prokurorisë ishte se ajo i kishte përmbushur të tëra detyrimet për nxjerrje materiali nëpërmjet nxjerrjes së Deklaratës së Dytë. Gjithashtu Prokuroria deklaroi se projektdeklaratat e dëshmitarit ishin hartuar gjatë të dy intervistave dhe ishin ruajtur elektronikisht në një kompjuter portativ, por se ajo nuk mund t'i gjente më në atë kompjuter portativ. Prokuroria bëri të ditur se kompjuterat portativë të përdorur në misione, përdoren nga organe të ndryshme të Tribunalit dhe se Prokuroria ia kishte kthyer kompjuterin portativ Seksionit të Tribunalit për Teknologjinë e Informacionit ("ITSS") i cili i fshiu të dhënat në mënyrë që kompjuteri të ishte i gatshëm për përdoruesin e radhës.¹³

8. Më 1 prill 2011, Dhoma konkludoi se Prokuroria nuk kishte detyrim për nxjerrje materiali në lidhje me Dëshmitarin 81 deri në 30 ditë para fillimit të procesit gjyqësor ose 45 ditë para dhënies së dëshmisë nga dëshmitari. Ajo e rrëzoi mocionin "pa paragjykim ndaj mocioneve të mëtejshme të Mbrojtjes për nxjerrje materiali lidhur me Dëshmitarin 81, pas fillimit të kësaj periudhe".¹⁴

9. Haradinaj parashtroi se më pas ai mori nga Prokuroria versionet e paredaktuara të Deklaratës së Parë dhe të Dytë, si dhe një deklaratë të mëtejshme nga Dëshmitari 81, me datë 4 korrik 2011 dhe dy deklarata dëshmitari nga një inspektor i policisë serbe në Beograd i cili e kishte intervistuar disa herë dëshmitarin.¹⁵ Gjithsesi Haradinaj kërkoi sërish nxjerrjen e materialit shtesë të lartpërmendur, megjithëse Prokuroria e kishte refuzuar kërkesën e tij.¹⁶

10. Ky Mocion paraqet tri kategori kryesore të materialit shtesë që Haradinaj kërkon të nxirret nga Prokuroria në bazë të Rregullës 68 dhe/ose Rregullës 66 (B).¹⁷

11. Së pari, Haradinaj kërkon të gjithë dokumentacionin e intervistave të Prokurorisë me Dëshmitarin 81. Veçanërisht ai pretendon se ka të drejtë të shohë dokumentin e ndryshimeve të bëra para se Dëshmitari 81 të nënshkruante Deklaratën e Parë.¹⁸ Ai parashtroi se

¹³ Mocion, para 14. Shih edhe *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Mocionit në Emër të Ramush Haradinajt për Nxjerrje të Materialeve Lidhur me Dëshmitarin 81, ("Përgjigje e Prokurorisë ndaj Mocionit të Mëparshëm për Nxjerrje Materiali") dorëzuar konfidencialisht më 11 shkurt 2011, para 3–7.

¹⁴ Mocion, para 17. Shih edhe *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Vendim mbi Mocionin e Haradinajt për Nxjerrje të Materialeve Lidhur me Dëshmitarin 81, 1 prill 2011, para 18.

¹⁵ Mocion, para 18.

¹⁶ Mocion, para 19.

¹⁷ Mocion, para 5, 20.

¹⁸ Mocion, para 5(a), 16, 26.

Prokuroria ka pranuar se Deklarata e Dytë përmban material shfajësues dhe se rrjedhimisht Mbrojtja ka të drejtë të shohë të gjitha dokumentet të cilët përbëjnë bazën e deklaratës.¹⁹ Gjithashtu Haradinaj pretendon se Prokurorisë do t'i duhet të paraqesë hetuesin që intervistoi Dëshmitarin 81 për pyetje nga Mbrojtja mbi mënyrën e përgatitjes së deklaratës dhe se materialet e kërkuara duhen për secilën prej pyetjeve.²⁰ Në përgjigje të pretendimit të Prokurorisë se dokumentet e hartuara në një kompjuter portativ nuk ekzistojnë më, kërkohet që Prokuroria të urdhërohet të vërë në dispozicion për verifikim kompjuterin portativ.²¹

12. Së dyti, Haradinaj kërkon të gjithë dokumentacionin e intervistave të Dëshmitarit 81 me zyrtarët serbë. Haradinaj argumenton se një inspektor i lartë i policisë, një prokuror i lartë dhe zyrtarë të tjerë serbë ishin të pranishëm në të gjitha intervistat e kryera nga Prokuroria me Dëshmitarin 81 dhe patën takime dhe intervista të veçanta me Dëshmitarin 81 gjatë një periudhe 25-ditore. Haradinaj deklaron se Prokuroria “duhet të ketë hetuar në lidhje me këto takime dhe intervista” midis Dëshmitarit 81 dhe zyrtarëve serbë, se me siguri këto materiale disponohen nga Prokuroria, dhe rrjedhimisht ajo duhet t’ia japë Mbrojtjes.²² Gjithashtu, Haradinaj argumenton se Prokuroria duhet të paraqesë dy zyrtarë të lartë serbë për pyetje nga Mbrojtja lidhur me komunikimin e tyre me Dëshmitarin 81.²³

13. Së treti, Haradinaj kërkon të gjithë dokumentacionin e kontakteve midis zyrtarëve serbë, Prokurorisë dhe Dëshmitarit 81, [REDAKTUAR]. Haradinaj thekson se bazuar në faktin se dëshmitari kontaktoi me Prokurorinë vetëm në tetor 2010, atij i nevojiten këto materiale për të përcaktuar motivin e Dëshmitarit 81 për të dëshmuar në një fazë të vonët të procesit.²⁴

14. Sipas Haradinajt, nxjerrja e këtyre materialeve është e nevojshme sepse ato kanë të bëjnë me një dëshmitar kyç të Prokurorisë, dëshmia e të cilit shfaq probleme serioze të besueshmërisë, sikundër provohet nga mospërputhjet midis Deklaratës së Parë dhe të Dytë, nga një konstatim i [REDAKTUAR] se dëshmitari nuk ishte i besueshëm në një proces gjyqësor [REDAKTUAR] dhe nga një verdikt fajësie të mëhershëm të dëshmitarët që

¹⁹ Mocion, para 21, 22.

²⁰ Mocion, para 28.

²¹ Mocion, para 25, 27, 38.

²² Mocion, para 29-32.

²³ Mocion, para 32-33.

²⁴ Mocion, para 3, 34-36.

sugjeron pandershëmëri.²⁵ Po ashtu Haradinaj argumenton se bazuar në faktin se është caktuar që Dëshmitari 81 të thirret nga Prokuroria për periudhën e mëpasme të seancave gjyqësore, shqyrtimi i menjëhershëm i materialeve është i domosdoshëm në lidhje me përgatitjen për dëshminë e dëshmitarit.²⁶

15. Në përgjigje, Prokuroria raporton se më 19 tetor 2011 i dha Mbrojtjes shënime të përfaqësuesit të Prokurorisë i pranishëm gjatë intervistave me Dëshmitarin 81 më 23-26 nëntor 2010, që rezultuan në Deklaratën e Parë dhe se janë nxjerrë të gjitha materialet e tjera në disponim të Prokurorisë lidhur me intervistat me Dëshmitarin 81.²⁷ Prokuroria saktëson se edhe një hetues i Prokurorisë ishte i pranishëm në Intervistën e Parë me Dëshmitarin 81, në nëntor 2010 dhe se ky hetues mbajti shënime gjatë intervistës. Gjithsesi Prokuroria bën të ditur se “këto shënime nuk ekzistojnë më” sepse “hetuesi i asgjësoi këto shënime më 7 dhjetor 2010 menjëherë pasi mospërputhjet nga Intervista e Parë u përfshinë në dokumentin elektronik i cili u bë Deklarata e Dytë”, e cila “u mor për arsye të zgjidhjes së problemit të mospërputhjeve në rrëfimin e Dëshmitarit 81 gjatë Intervistës së Parë”.²⁸

16. Prokuroria argumenton se nuk mund të përmbushë kërkesën e Haradinajt për dokument të ndryshimeve të bëra para nënshkrimit të Deklaratës së Parë nga Dëshmitari 81²⁹ dhe jep shpjegimin e mëtejshëm:

Projektversioni i Deklaratës së Parë i cili do të tregonte ndryshimet, nuk disponohet nga Prokuroria. Këto ndryshime u bënë gjatë procesit të quajtur “lexim për dëshmitarin” [...]. Në kuadër të Intervistës së Parë, ishte përgatitur një version operativ i deklaratës, të cilin dëshmitari duhej ta miratonte, bazuar në shënime të përfaqësuesit të Prokurorisë dhe hetuesit [...] së bashku me dëshmitarin u verifikua versioni elektronik i projektdeklaratës së pamiratur për të garantuar që ajo të pasqyronte saktësisht fjalët dhe rrëfimin e vetë dëshmitarit për ngjarjen. [...]

Ndryshimet e bëra gjatë procesit të leximit për dëshmitarin të Intervistës së Parë u përfshinë elektronikisht në projektdeklaratë [...]. Menjëherë pasi Dëshmitari 81 miratoi versionin operativ si deklaratë e tij, ajo u ruajt, u shtyp dhe dëshmitari e nënshkroi.³⁰

17. Mirëpo Prokuroria pretendon se dhënia e shënimeve të përfaqësuesit të saj përbën dokument të të gjitha ndryshimeve të bëra gjatë intervistave që rezultuan në Deklaratën e Parë dhe si rrjedhim përmbush kërkesën e Haradinajt.³¹ Ndryshe ajo thekson se gjatë

²⁵ Mocion, para 2-3, 22, 36.

²⁶ Mocion, para 3.

²⁷ Përgjigje, para 2, 5.

²⁸ Përgjigje, para 6.

²⁹ Përgjigje, para 8. Shih edhe Mocion para 5(a), 16, 26.

³⁰ Përgjigje, para 8, 10.

³¹ Përgjigje, para 2.

intervistave të mëpasme me Dëshmitarin, konkretisht më 7 dhe 8 dhjetor 2010, 27 dhe 30 qershor 2011 dhe 1 dhe 4 korrik 2011, nuk u mbajtën shënime. Sikundër është raportuar, deklarata që doli nga këto intervista u shkrua drejtpërsëdrejti në kompjutera.³²

18. Për më tepër, Prokuroria parashtron se deklaratimet e saj të mëparshme se Deklarata e parë ishte hartuar në një kompjuter portativ që më pas iu kthye ITSS-së së Tribunalit dhe iu fshinë të dhëna, faktikisht është e pasaktë. Prokuroria sqaron se versioni operativ i Deklaratës së Parë u hartua në një kompjuter zyre të Zyrës në Terren të Beogradit dhe u transferua në një kompjuter portativ me anë të një fishe USB. Mirëpo Prokuroria gjykon se dhënia e shënimeve të lartpërmendura të përfaqësuesit të saj i ofron Haradinajt material të mjaftueshëm për të pyetur Dëshmitarin 81.³³

19. Prokuroria konfirmon se i ka dhënë Haradinajt të gjitha dokumentet që disponon të intervistave të Dëshmitarit 81 me zyrtarët serbë. Ajo parashtron se nuk disponon dokumente të tjera të këtyre intervistave me zyrtarë serbë, dhe as nuk ka parë dokumente të tilla.³⁴ Gjithashtu pohohet se asnjë letërkëmbim apo dokument tjetër i kontakteve midis zyrtarëve serbë, Prokurorisë dhe Dëshmitarit 81, nuk është brenda kuadrit të nxjerrjes së materialeve.³⁵ [REDAKTUAR].³⁶

20. Prokuroria deklaron se informacioni i kërkuar nga Haradinaj lidhur me rrethanat në të cilat Prokuroria mësoi për ekzistencën e Dëshmitarit 81, për programin e mbrojtjes së dëshmitarëve ku merr pjesë dëshmitari dhe informacioni lidhur me dëshmitarin, i janë bërë të gjitha të njohura Mbrojtjes.³⁷

21. Gjithashtu, Prokuroria thekson se nuk ka ndërmend të thërrasë hetuesin e Prokurorisë ose zyrtarët serbë të cilët intervistuan Dëshmitarin 81 dhe se Haradinaj nuk mund të detyrojë Prokurorinë që t'i bëjë ata të paraqiten për pyetje nga Mbrojtja.³⁸

³² Përgjigje, para 7.

³³ Përgjigje, para 11.

³⁴ Përgjigje, para 3, 12.

³⁵ Përgjigje, para 14.

³⁶ Përgjigje, para 15.

³⁷ Përgjigje, para 4, 16.

³⁸ Përgjigje, para 17.

22. Në Kundërpërgjigjen e tij, Haradinaj proteston veçanërisht se nxjerrja prej Prokurorisë e shënimeve të përfaqësuesit të saj më 19 tetor 2011 nuk ishte në kohë, sepse duhej të ishte bërë jo më vonë se 19 korrik 2011.³⁹ Gjithashtu Haradinaj kritikon asgjësimin e shënimeve të hetuesit dhe kërkon që Dhoma të urdhërojë hetuesin që të ofrojë një shpjegim të plotë të sjelljes së tij lidhur me asgjësimin e shënimeve të tij.⁴⁰ Ai gjithashtu kërkon që Dhoma t'a lejojë që të kontrollojë kompjuterat dhe fishën në disponim të Prokurorisë për deklarata të mëhershme të Dëshmitarit 81.⁴¹

23. Haradinaj rithekson se Prokuroria duhet të sigurojë dhe nxjerrë të gjitha materialet lidhur me Dëshmitarin 81 që kanë autoritetet serbe.⁴² Sipas Haradinajt, Prokuroria “ka kompetencën dhe kontaktet e nevojshme me autoritetet serbe për të kërkuar dhënien e këtij materiali brenda një kohe të shkurtër”.⁴³ Ai deklaron se “realisht ai nuk mund të marrë informacionin në mënyrën e sugjeruar nga Prokuroria”, veçanërisht duke mbajtur parasysh se sikundër pretendohet “këto autoritete nuk i janë përgjigjur asnjë kërkesë për informacion bërë nga Mbrojtja e Balajt që në korrik 2011”.⁴⁴ Më tej parashtrohet se një Dhomë Gjyqësore gjithashtu mund të urdhërojë një shtet që të japë informacion dhe rrjedhimisht kërkohet që Dhoma të urdhërojë autoritetet serbe që këtë material t'ua japin gjykatës dhe palëve.⁴⁵

24. Po ashtu, Haradinaj nuk e pranon parashtrimin e Prokurorisë se ajo nuk disponon material tjetër të Rregullës 68. Haradinaj argumenton se bazuar në shkeljet e mëhershme prej Prokurorisë të Rregullës 68, “Prokuroria duhet të urdhërohet të dorëzojë një raport të hollësishëm mbi nxjerrjen e materialit ku të rendisë çdo dokument që ka Prokuroria lidhur me kontaktet e saj me Dëshmitarin 81 dhe autoritetet serbe dhe të japë një përmbledhje të përmbajtjes së çdo dokumenti dhe arsyet e pretendimit të Prokurorisë për mosnxjerrjen e dokumenteve të tilla”.⁴⁶ Së fundi, Haradinaj përsërit kërkesën që hetuesi i Prokurorisë dhe zyrtarët serbë që intervistuan Dëshmitarin 81 të jenë të disponueshëm për pyetje nga Mbrojtja dhe argumenton se Dhoma mund të nxjerrë urdhrin përkatës bazuar në Rregullën 98.⁴⁷

³⁹ Kundërpërgjigje, para 3, 11-13.

⁴⁰ Kundërpërgjigje, para 4, 14-17, 36.

⁴¹ Kundërpërgjigje, para 10, 23-25.

⁴² Kundërpërgjigje, para 24-26.

⁴³ Kundërpërgjigje, para 26.

⁴⁴ Kundërpërgjigje, para 26.

⁴⁵ Kundërpërgjigje, para 26.

⁴⁶ Kundërpërgjigje, para 7. Shih po aty në 29-32.

⁴⁷ Kundërpërgjigje, para 26-36.

II. LIGJI PËRKATËS

25. Në Rregullës 66(A)(ii) të Rregullores së Procedurës dhe Provave (“Rregullorja”) përcaktohet se “në varësi të dispozitave të Rregullave 53 dhe 69, Prokurori vë në dispozicion të mbrojtjes, në një gjuhë që e kupton i akuzuari [...] kopjet e deklaratave të të gjithë dëshmitarëve të cilët Prokurori synon t’i thërrasë për të dëshmuar në gjyq [...]”. Gjithashtu në paragrafin B të Rregullës 66 përcaktohet se “pas një kërkesë, Prokurori mund ta lejojë mbrojtjen që të verifikojë çfarëdo libri, dokumenti, [...] në zotërimin ose kontrollin e Prokurorit, që janë juridikisht thelbësore për përgatitjen e mbrojtjes”.

26. Lidhur me Rregullën 66(A)(ii) Dhoma e Apelit ka konkluduar se “kuptimi i zakonshëm i një deklarate dëshmitari në proces gjyqësor është rrëfimi prej një personi i dijenisë së një krimi që dokumentohet gjatë procedurës së hetimit të krimit”.⁴⁸ Gjithashtu ajo ka konkluduar se “dokumentet e pyetjeve të Prokurorisë për një dëshmitar dhe përgjigjet e dhëna përbëjnë deklaratë dëshmitari sipas Rregullës 66(A)(ii)”. Pasi dëshmitarit i është bërë një pyetje e cila rrjedhimisht është pjesë e deklaratës së dëshmitarit, ajo është e ndryshme nga “dokumentet e brendshme të përgatitura nga një palë” në bazë të Rregullës 70(A) dhe nuk gëzon mbrojtjen që ofron kjo rregull.⁴⁹

27. “Prokuroria ka detyrim që t’i japë Mbrojtjes një deklaratë dëshmitari në formën në të cilën është dokumentuar”.⁵⁰ Versionet paraprake të një deklarate dëshmitari të transkriptuara nga një person tjetër duhet të nxirren sepse paragrafi A i Rregullës 66 nuk kufizohet vetëm në deklaratat zyrtare përfundimtare që janë nënshkruar dhe miratuar nga dëshmitari.⁵¹ Nuk

⁴⁸ *Prokurori k. Bllashkiqit*, Lënda Nr. IT-95-14-A, Vendim mbi Mocionin e Apeluesit për Nxjerrje Materiali, Pezullim ose Zgjatje të Kalendarit të Parashtrimeve dhe Parashtrime Shtesë, 26 shtator 2010, (“Vendimi i Apelit Bllashkiq”) para 15; Shih edhe *Prokurori k. Millutinoviqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-05-87-T, Vendim mbi Mocionin e Ojdaniqit për Nxjerrje të Deklaratave të Dëshmitarëve dhe për Konstatim të Shkeljes së Rregullës 66 (A)(ii), 29 shtator 2006, para 14.

⁴⁹ *Prokurori k. Niyitegeka-s dhe të tjerëve*, Lënda Nr. ICTR-96-14-A, Aktgjykim, 9 korrik 2006, para 33, 34 (“Aktgjykimi i Apelit Niyitegeka”). Rregulla 70(A) përcakton se pavarësisht nga dispozitat e Rregullës 66 dhe 67 “raportet, përkujtesat ose dokumentet e tjera të brendshme të përgatitura nga një palë, [...], përjashtohen nga detyrimi i nxjerrjes së materialit ose i njoftimit sipas Rregullores”. Shih edhe *Prokurori k. Brima-s dhe të tjerëve*, Lënda Nr. SCSL-04-16-T, Vendim mbi Mocionin e Përbashkët të Mbrojtjes për Nxjerrjen e të Gjitha Deklaratave Origjinale të Dëshmitarit, Shënimeve të Intervistës dhe Shënimeve të Hetuesve sipas Rregullës 66 dhe 68, 4 maj 2005, f 6.

⁵⁰ Aktgjykimi i Apelit *Niyitegeka*, para 13.

⁵¹ *Prokurori k. Bllashkiqit*, Lënda Nr. IT-95-14-PT, Vendim mbi Paraqitjen e Materialeve Zbuluese, 30 janar 1997, para 37-38 (“Vendimi Bllashkiq i 27 janarit 1997”).

ekziston ndryshim ligjor midis deklaratave zyrtare të nënshkruara nga një dëshmitar dhe deklaratave të tjera.⁵²

28. Për më tepër në Rregullën 68(i) të Rregullores përcaktohet se “sa më shpejt që të ketë mundësi, Prokurori i bën të njohur Mbrojtjes çdo material i cili, me sa është në dijeni Prokurori, mund të çojë drejt sugjerimit të pafajësisë ose lehtësimit të fajësisë së të akuzuarit, ose mund të ndikojë në besueshmërinë e provave të Prokurorit”

29. Kohët e fundit Dhoma ka analizuar ligjin lidhur me Rregullën 68.⁵³ Veçanërisht Dhoma thekson se “kriteri i vlerësimit nëse materiali është shfajësues brenda kuptimit të Rregullës 68(A) të Rregullores është nëse duke marrë parasysh argumentet e palëve ekziston *ndonjë mundësi* që informacioni në fjalë të jetë i rëndësishëm për mbrojtjen e të akuzuarit”.⁵⁴

30. Së fundi, Rregulla 85 tregon praktikën themelore të paraqitjes së provave në Tribunal. Veçanërisht përcaktohet se e para që paraqet provat është Prokuroria e më pas Mbrojtja, nëse dëshiron e në vijim kundërprovat e Prokurorisë dhe kundërprovat e Mbrojtjes pasuar prej provave të urdhëruara nga Dhoma bazuar në Rregullën 98 ku konkretisht përcaktohet se “Dhoma Gjyqësore mund të urdhërojë cilëndo palë të paraqesë prova shtesë”.

III. DISKUTIM

A. Asgjësimi i shënimeve të hetuesit

31. Dhoma thekson me shqetësim se shënimet e hetuesit të Prokurorisë të intervistës fillestare me Dëshmitarin 81 “u asgjësuan” më 7 dhjetor 2010.⁵⁵ Deklarata e Parë u bazua pjesërisht në këto shënime,⁵⁶ duke treguar në këtë mënyrë se ato janë dokument i deklaratave të Dëshmitarit 81.

⁵² Po aty.

⁵³ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Vendim mbi Mocionin e Përbashkët të Mbrojtjes për Masë Zhdëmtuese kundër Shkeljeve të Rregullës 68 nga Prokuroria dhe për Sanksione sipas Rregullës 68bis, 12 tetor 2011 (“Vendim i Rregullës 68 i 12 tetorit 2011”), para 37-44.

⁵⁴ Vendim i Rregullës 68 i 12 tetorit 2011, para 38 (theksi i shtuar). Shih edhe *Prokurori k. Llukiqit dhe Llukiqit*, Lënda Nr. IT-98-32/1-T, Vendim Konfidencial mbi Mocionin e Millan Llukiqit për Masë Zhdëmtuese Kundrejt Shkeljeve të Rënda për Nxjerrje Materiali prej Prokurorisë, 12 maj 2011 (“Vendimi Llukiq”), para 14.

⁵⁵ Përgjigje, para 6.

⁵⁶ Përgjigje, para 8.

32. Jurisprudenca e Tribunalit kushtëzon se bazuar në Rregullën 66(A)(ii) Prokuroria duhet t'u japë të Akuzuarve të gjitha deklaratat e mëparshme të një dëshmitari.⁵⁷ Deklaratat që duhen nxjerrë për Mbrojtjen nuk janë vetëm deklaratat zyrtare që janë nënshkruar ose miratuar nga dëshmitari.⁵⁸ Çdo gjë që dëshmitari thotë dhe shkruan e që ka lidhje me aktakuzën është deklaratë dhe duhet t'i nxirret Mbrojtjes në qoftë se bie në duar të Prokurorisë ose Prokuroria vihet në dijeni të saj, ndër të cilat edhe deklaratat që janë transkriptuar ose janë raportuar gojarisht nga një person tjetër. Prokuroria duhet t'i kishte bërë të njohur Mbrojtjes shënimet e hetuesit sepse ato përmbanin ose përmbledhnin deklarata të bëra nga Dëshmitari 81.

33. Veç detyrimeve për nxjerrje materiali sipas Rregullës 66(A)(ii), Dhoma thekson se Rregulla 68(i) po ashtu kërkon që Prokuroria të nxjerrë deklarata të mëhershme mospërputhëse dhe çfarëdo materiali tjetër që ka rëndësi për besueshmërinë e dëshmitarit.⁵⁹ Në këtë rast Prokuroria ishte e vetëdijshme se rrëfimi i Dëshmitarit 81 nuk përputhej tërësisht sepse sikundër argumenton vetë “Deklarata e Dytë u mor për arsye të zgjidhjes së problemit të mospërputhjeve të rrëfimit të Dëshmitarit 81 gjatë Intervistës së Parë”.⁶⁰ Për aq sa këto mospërputhje pasqyroheshin në shënimet e hetuesit, shënimet duhet të ishin nxjerrë në bazë të Rregullës 68(i).

B. Nxjerrja e vonuar e shënimeve të përfaqësuesit të Prokurorisë të intervistës fillestare me Dëshmitarin 81

34. Dhoma nënvizon se nxjerrja prej Prokurorisë më 19 tetor 2011 e shënimeve të përfaqësuesit të saj për intervistën nuk ishte në kohë dhe rrjedhimisht përbën shkelje të Rregullës 66(A)(ii) dhe 68(i). Shënimet e përfaqësuesit të Prokurorisë përmbanin deklarata të Dëshmitarit 81.⁶¹ Rrjedhimisht Prokuroria duhet ta kishte nxjerrë këtë provë brenda 19 korrikut 2011, datë në të cilën mbaronte afati i masës mbrojtëse për nxjerrje të vonuar materiali miratuar për Dëshmitarin 81. Duke marrë parasysh se Dhoma u atribuon të gjithë palëve paraprakisht ndershmëri në kryerjen e procesit, veçanërisht në lidhje me aspekte mbi të drejtat e të akuzuarve, ajo i tërheq vërejtjen Prokurorisë për mosnxjerrjen e këtyre

⁵⁷ Aktgjykimi i Apelit *Niyitegeka*, para 13, 33-34; Vendimi *Bllashkiq* i 27 janarit 1997, para 37-38.

⁵⁸ Aktgjykimi i Apelit *Niyitegeka*, para 13, 33-34; Vendimi *Bllashkiq* i 27 janarit 1997, para 37-38.

⁵⁹ Shih Vendim i Rregullës 68 i 12 tetorit 2011, para 38

⁶⁰ Përgjigje para 6.

⁶¹ Përgjigje para 8.

shënimeve deri kur ato u kërkuar nga Mbrojtja, fakt që shënon herën e dytë kur Prokuroria nuk ka nxjerrë materiale me nismën e vet.⁶²

C. Kërkesa e Haradinajt për dokument të ndryshimeve të bëra para se Dëshmitari

81 të nënshkruante Deklaratën e Parë

35. Haradinaj argumenton se ai ka të drejtë të shohë dokumentin e ndryshimeve të bëra në projektdeklaratën e parë para se të nënshkruhet nga Dëshmitari 81.⁶³ Prokuroria kundërpërgjigjet se nuk ekziston dokument i të gjitha ndryshimeve bërë në projektdeklaratë para se të nënshkruhet nga Dëshmitari 81, sepse Prokuroria përdori procedurën e “leximit të deklaratës për dëshmitarin” në përgatitjen e deklaratës,⁶⁴ dhe se versioni operativ i deklaratës është fshirë.⁶⁵

36. Problemi themelor i ngritur në Mocionin e Haradinajt nuk është nxjerrja e versioneve të mëhershme të deklaratës përfundimtare të një dëshmitari, por nxjerrja e çfarëdo deklarate mospërputhëse të dëshmitarit. Dhoma është e ndërgjegjshme se një dëshmitar mund të ndryshojë rrëfimin e tij ose të saj gjatë intervistës. Në këto rrethana, rrëfimi origjinal i një dëshmitari mund të jetë deklaratë mospërputhëse e mëhershme të cilën Prokuroria duhet t’a nxjerrë në bazë të Rregullës 66(A)(ii) dhe Rregullës 68(i).

37. Dhoma thekson se Prokuroria ka detyrim të përgjithshëm të përpilojë një dokument të çfarëdo mospërputhjeje në rrëfimin e një dëshmitari. Për këtë arsye Prokuroria duhet të garantojë se çfarëdo mospërputhjeje në rrëfimin e dëshmitarit gjatë një interviste me Prokurorinë duhet të pasqyrohet qartësisht dhe t’i bëhet e njohur Mbrojtjes në bazë të Rregullave 66(A)(ii) dhe 68(i).

38. Prokuroria pranon se e mori Deklaratën e Dytë nga Dëshmitari 81 për shkak të “mospërputhjeve” që ekzistonin në rrëfimin e tij gjatë intervistave që rezultuan në Deklaratën e Parë.⁶⁶ Prokuroria parashtroi se më 19 tetor 2011 ajo nxori shënimet e përfaqësuesit të saj mbajtur gjatë intervistës së parë me Dëshmitarin 81. Për shkak se këto shënime nuk janë në

⁶² Shih Vendim i Rregullës 68 i 12 tetorit 2011.

⁶³ Mocion para 5(a), 16, 26.

⁶⁴ Përgjigje para 8-10.

⁶⁵ Përgjigje para 11.

⁶⁶ Përgjigje para 6.

zotërim të Dhomës e cila natyrisht nuk kishte dijeni për intervistën, për Dhomën mbetet e paqartë nëse këto shënime pasqyrojnë në mënyrën dhe masën e duhur ndryshimet e bëra në rrëfimin e Dëshmitarit 81. Prokuroria nuk jep informacion as për materialin në të cilin u bazua për përcaktimin e mospërputhjeve në Deklaratën e Parë që e shtynë të merrte Deklaratën e Dytë.

39. Rrjedhimisht, Dhoma do të miratojë për aq sa është e mundshme kërkesën e Haradinajt për një dokument të ndryshimeve të bëra në projektdeklaratën e parë para se të nënshkruhej nga Dëshmitari 81. Prokuroria konfirmon se projektdeklarata e parë është fshirë⁶⁷ dhe rrjedhimisht nuk mund t'i bëhet e njohur Mbrojtjes. Së fundi Dhoma e ka urdhëruar Prokurorinë që të japë informacion për identifikimin e dosjes elektronike që përmbante projektdeklaratën e cila iu lexua Dëshmitarit 81 më 26 nëntor 2011 dhe i ka kërkuar ITSS-së së Tribunalit që të informojë Dhomën nëse mund të gjendet kjo dosje elektronike. Rrjedhimisht në këtë moment Dhoma nuk do të lëshojë urdhër tjetër lidhur me këtë problem.

D. Kërkesa e Haradinajt që Prokuroria të sigurojë dhe të nxjerrë materiale në zotërim të autoriteteve serbe

40. Haradinaj ka kërkuar që Prokuroria të sigurojë dhe të nxjerrë dokumente të intervistave që autoritetet serbe kanë bërë me Dëshmitarin 81,⁶⁸ si dhe dokumente të tjera që mund të kenë autoritetet serbe për Dëshmitarin 81.⁶⁹

41. Dhoma merr shënim parashtrimin e Haradinajt se “realisht ai nuk mund të lihet të marrë informacion nga autoritetet serbe sikundër sugjerohet nga Prokuroria”, dhe se sipas tij këto autoritete “nuk i janë përgjigjur asnjë kërkesë për informacion bërë nga Mbrojtja e Balajt që në korrik 2011”.⁷⁰

42. Gjithsesi Dhoma thekson se Rregulla 66(B) kushtëzon që pas një kërkesë, Prokurori mund ta lejojë mbrojtjen që të verifikojë materiale “në zotërimin ose kontrollin e Prokurorit”. Për arsye se këto materiale janë në zotërimin dhe kontrollin e autoriteteve serbe, dhe jo të

⁶⁷ Përgjigje para 11.

⁶⁸ Kundërpërgjigje, para 24.

⁶⁹ Kundërpërgjigje, para 26.

⁷⁰ Kundërpërgjigje, para 26.

Prokurorisë, Dhoma konkludon se Mbrojtja nuk mund të detyrojë Prokurorinë që të sigurojë dhe nxjerrë këto materiale. Dhoma thekson se procedura e duhur është që Haradinaj t'i paraqesë një mocion Dhomës ku të kërkojë urdhërparaqitje të këtyre materialeve.

E. Kërkesa e Haradinajt për informacion tjetër lidhur me Dëshmitarin 81

43. Fillimisht Dhoma rrëzon kërkesën e Haradinajt që të urdhërojë Prokurorinë për paraqitjen e një raporti të hollësishëm mbi nxjerrjen e materialit ku të rendisë çdo dokument që zotëron lidhur me kontaktet me Dëshmitarin 81 dhe autoritetet serbe me një përmbledhje të përmbajtjes së çdo dokumenti dhe duke saktësuar arsyen pse Prokuroria mendon se këto materiale nuk duhen nxjerrë.⁷¹ Dhoma gjykon se në këtë fazë është e panevojshme një masë e tillë, duke qenë se e ka rikujtuar Prokurorinë më parë për detyrimet e saj sipas Rregullës 68.⁷²

44. Gjithashtu Haradinaj kërkon të gjithë dokumentimin e kontakteve midis Prokurorisë dhe Dëshmitarit 81.⁷³ Dhoma e gjykon edhe këtë kërkesë të papërligjur. Prokuroria është e detyruar të nxjerrë materiale dhe deklarata nga Dëshmitari 81 brenda kuadrit të Rregullës 66(A)(ii) dhe 68(i). Edhe kjo kërkesë nuk është brenda kuadrit të Rregullës 66(B), e cila e detyron Prokurorinë që të nxjerrë për verifikim materiale që “janë juridikisht të rëndësishme në përgatitjen e mbrojtjes”.

45. Haradinaj kërkon një dokument të të gjitha komunikimeve midis Prokurorisë dhe autoriteteve serbe lidhur me dëshminë e Dëshmitarit 81.⁷⁴ Sërish Dhoma gjykon se kjo kërkesë është e papërligjur. Prokuroria duhet të nxjerrë vetëm komunikimet që janë brenda kuadrit të Rregullës 66(A)(ii) dhe Rregullës 68(i).

46. Së fundi, Haradinaj kërkon informacion mbi rrethanat në të cilat Prokuroria mësoi për ekzistencën e Dëshmitarit 81 dhe implikimin e Prokurorisë në “programin për mbrojtjen e dëshmitarëve” të Dëshmitarit 81.⁷⁵ Prokuroria bën të ditur se ajo tashmë ia ka dhënë këtë informacion Mbrojtjes.⁷⁶ Rrjedhimisht duket se ky problem është i tejkaluar. Gjithsesi Haradinaj pretendon se Prokuroria duhet “të paraqesë për pyetje nga Mbrojtja” zyrtarë serbë

⁷¹ Kundërpërgjigje, para 7.

⁷² Shih Vendim i Rregullës 68 i 12 tetorit 2011.

⁷³ Mocion, para 34.

⁷⁴ Mocion, para 34, 36.

⁷⁵ Mocion, para 35.

⁷⁶ Përgjigje, para 4, 16.

të cilët mund të ndriçojnë rrethanat e daljes së Dëshmitarit 81 si dëshmitar i Prokurorisë.⁷⁷ Ky pretendim nuk ka bazë dhe diskutohet më poshtë.

F. Kërkesa e Haradinajt që Prokuroria të paraqesë dëshmitarë për pyetje nga

Mbrojtja

47. Haradinaj pretendon që Prokuroria duhet “të sjellë për t’u pyetur nga Mbrojtja” hetuesin e Prokurorisë i cili intervistoi Dëshmitarin 81 si dhe dy zyrtarë të lartë serbë të pranishëm në atë intervistë.⁷⁸

48. Dhoma gjykon se ky pretendim nuk ka bazë dhe nuk gjen mbështetje në praktikën gjyqësore të Tribunalit mbi paraqitjen e provave sipas Rregullës 85. Prokuroria duhet të paraqesë për pyetje nga Mbrojtja vetëm personat të cilët janë dëshmitarë të Prokurorisë në një proces gjyqësor. Në qoftë se një dëshmitar nuk është thirrur nga Prokuroria dhe Mbrojtja dëshiron që ai të dëshmojë, Mbrojtja mund ta thërrasë dëshmitarin që të dëshmojë për të. Gjithashtu Mbrojtja mund t’i kërkojë Dhomës që të lëshojë një urdhërparaqitje për të dëshmuar për një person, në qoftë se ai ose ajo nuk është i gatshëm/e gatshme të dëshmojë me vullnet të lirë.

49. Megjithëse Rregulla 98 e lejon Dhomën Gjyqësore që të urdhërojë Prokurorinë për paraqitjen e provave shtesë, ajo nuk duhet të përdoret në një rast si ky, ku Haradinaj kërkon të detyrojë Prokurorinë që të paraqesë prova që ai mund të ofrojë për mbrojtjen e tij. Gjithashtu, megjithëse Dhoma mund të urdhërojë paraqitjen e provave sipas Rregullës 98, Rregulla 85 saktëson se Dhoma mund ta bëjë këtë vetëm pas paraqitjes së provave nga palët, duke përfshirë edhe kundërprovat e tyre.

G. Statusi i Protokollimit të Vendimit Aktual

50. Megjithëse Mocioni, Përgjigjja dhe Kundërpërgjigjja u dorëzuan konfidencialisht, Dhoma gjykon ky vendim mund të protokollohet publikisht. Rrjedhimisht Dhoma i urdhëron

⁷⁷ Kundërpërgjigje, para 34.

⁷⁸ Mocion, para 28, 33. Kundërpërgjigje, para 8, 10, 17, 33-35.

palët që brenda një jave të dorëzojnë parashtrime ku të bëjnë të ditur çfarë pjesësh të këtij vendimi, në qoftë se nevojitet, duhet të redaktohen për arsye konfidencialiteti para se vendimi të bëhet publik.

IV. VENDIM

51. Për arsyet e lartpërmendura, me anë të këtij vendimi, Dhoma
- a. **MIRATON** kërkesën e Haradinajt për të paraqitur kundërpërgjigje dhe merr shënim përmbajtjen e Kundërpërgjigjes;
 - b. **MIRATON** kërkesën e Haradinajt për tejkalimin e numrit-kufi të fjalëve në parashtrimet e tij;
 - c. **UDHËZON** Prokurorinë që të marrë masa për të garantuar që të gjithë punonjësit që punojnë në këtë çështje të vihen plotësisht në dijeni për vendimin e Dhomës dhe t'u përmenden detyrimet e Rregullës 66(A)(ii) dhe 68;
 - d. **MIRATON PJESËRISHT** Mocionin e Haradinajt sikundër parashtrohet në paragrafin 39 të Vendimit;
 - e. **RRËZON** Mocionin e Haradinajt lidhur me të gjitha pikat e tjera;
 - f. **URDHËRON** palët që brenda një jave të dorëzojnë parashtrime ku të bëjnë të ditur çfarë pjesësh të këtij vendimi, në qoftë se nevojitet, duhet të redaktohen për arsye konfidencialiteti para se vendimi të bëhet publik

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

/nënshkruar në origjinal/
Gjykatës Bakone Justice Moloto
Kryegjykatës

Sot, më 18 nëntor 2011.
Në Hagë
Holandë

[Vula e Tribunalit Ndërkombëtar]